



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
Sekretaria

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.12.2021

**MBLEDHJA Nr. 58,**  
**datë 13.12.2021, ora 14:30**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 13.12.2021, ora 14:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 58 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Nëntor 2021
2. Mbi fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar me vendimin Nr.177, datë 08.11.2016 të bordit të ERE
3. Mbi rishikimin e vendimit nr. 110, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k, për rishikimin e vendimit nr. 35, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar”
4. Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k, për rishikimin e vendimit nr. 32, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar”
5. Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k, për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar”
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k. ndërmjet ortakëve ekzistues të shoqërisë
7. Informacion mbi monitorimin e kryer pranë shoqërisë FSHU sh.a. me qëllim marrjen në dijeni dhe masat e marra për zbatimin e detyrimeve që burojnë nga plani i masave për periudhën Janar – Shtator 2021
8. Çështje të tjera

Në zbatim të: (i) pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; (ii) Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”; (iii) Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”; dhe (iv) Urdhërit nr. 19, datë 19.02.2021, “Për ndryshimin e pikës 1, të Urdhërit nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, për lejimin e pjesëmarrjes së palëve të treta, nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik, për sa i përket zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Bordit, si dhe zhvillimin e seancave dëgjimore teknike apo publike.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**